

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 16 QERSHOR 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa asnjë diskutim që është një moment i rëndësishëm kur diskutojmë për institucionet e pavarura, të cilat bëjnë komentet e tyre, në mënyrë të veçantë për ekonominë e vendit. Sigurisht, ne jemi shpresëmëdhenj dhe presim gjithmonë me padurim që Banka e Shqipërisë ta bëjë këtë gjë, sepse kush mund ta bëjë tjetër veç saj?! Ne nuk kemi iluzionin që klubi i batakçinjve këtu mbrapa do të bëjë këtë gjë. E dimë shumë mirë që do të përpiqen t'i bindin shqiptarët se është më mirë të paguajnë 2600 lekë një litër naftë sesa ta paguajnë 1800 lekë, sa në Maqedoni, se është më mirë kur paguan më shumë, është më e dobishme, është më e gëzueshme për qytetarët!

Por, në rastin konkret, ne nuk duam ta shikojmë Bankën e Shqipërisë si damën e shoqërimin të qeverisë, absolutisht jo, sepse ne nuk mund të pranojmë që borxhi i jashtëm të bjerë, ndërkohë që qeveria merr në fund të vitit 700 milionë euro Eurobond. Ne nuk mund të pranojmë që ta dëgjojmë këtë lloj bisede. Gjithashtu, ne presim që në momente kaq të vështira ekonomike, Banka e Shqipërisë, e cila ka në rreshtin e parë të misionit të saj kontrollin mbi çmimet, të jetë aktive, të jetë një oponente teknike shumë e fortë dhe e papajtueshme.

I kemi sytë nga ajo, siç i kanë të gjitha vendet e tjera, por shikojmë mesazhe rozë të një Shqipërie, që nuk ka lidhje me Shqipërinë reale, të një Shqipërie nga ku ikin qindra e mijëra njerëz, të një Shqipërie, e cila është më pak atraktivja në rajon për të tërhequr bizneset, të një Shqipërie ku nuk hyn asnjë biznes i huaj i rëndësishëm, të një Shqipërie që i shkon borxhi 106,5%, ku thirrjet për ta deklaruar borxhin e vërtetë vijnë nga FMN-ja, dhe të gjitha këto ne presim që në mënyrë normale t'i bëjë Banka e Shqipërisë, e cila ka autoritetin, ka kompetencën profesionale dhe të gjitha mundësitë t'i bëjë, sepse është provuar jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende shumë më të forta ekonomisht se Shqipëria që, kur neglizhohen dhe nuk ngrihen alarmet në kohën e duhur, dita e kolapsit vjen nga sot në nesër.

Nuk mendoj kurrë se ka ndonjë iluzionin e një Shqipërie shumë të fortë, solide e të patundur ekonomike, cilatdo qofshin truket që mund të bëhen me shifrat. Ne e kemi shumë të qartë se ky është moment më delikat edhe për çmimet, për të cilat FMN-ja nga përtej Atlantikut ngriti alarmin dhe tha se instrumenti më i papërshtatshëm, që duhet abroguar në çast, ishte bordi i transparencës. Pse duhej të vinte dhe të na e thoshte FMN-ja këtë gjë, në rast se ne kemi mundësi që një oponencë të tillë tekniko-profesionale ta kemi këtu?!

Cilat ishin alarmet që duhej të jepeshin, sepse ka një ngjarje të rëndësishme: Banka Qendrore Europiane ka dyfishuar nivelet e interesit dhe ne kemi kredi të mëdha në euro, pavarësisht se kjo sallë në shumë raste është indiferente për këta tregues shumë të rëndë ekonomikë dhe është shumë e afektuar të dëgjojë batuta idiote, të cilat krijojnë vetëm ilaritetin e radhës, por, njëkohësisht, një lloj përqeshjeje me varfërinë? Pra, mesazhet në këtë plan janë shumë të rënda, sepse dihet që në prill Banka e Shqipërisë i ka dyfishuar normat e interesit.

Cilat mund të jenë mesazhet optimiste të një ekonomie të tillë, kur nivelet e interesit rriten, borxhi fluturon, investime të huaja nuk ka, s'jemi kompetitivë, jemi vendi i dytë në botë për korrupsion, kemi paqëndrueshmërinë më të madhe të administratës publike të vulosur nga Europa, nga FMN-ja, nga Banka Botërore dhe nga të gjithë? Ky lloj optimizmi ngjan tamam si luajtja me violinë, ndërsa Titaniku mbytej, por luajtja me violinë nuk e ndali dot Titanikun të mbytej dhe të merrte me vete mijëra jetë njerëzish. Kjo ka të bëjë në marrjen me vete të qindra milionë eurove të ekonomisë shqiptare, të cilat dalin nga xhepat e shqiptarëve dhe nuk kthehen dot më, por vetëm shtojnë tragjedinë e dramën dhe bëjnë që qindra e mijëra të tjerë të kenë në mend vetëm një zgjidhje: të largohen nga Shqipëria.

Është dita që t'i kundërvihemi këtij komunizmi të ri ekonomik, sepse dihet që alternativat e komunizmit kanë qenë vetëm tri: mbyllja e gojës, largimi nga vendi ose prehja nën dhé, pra mosekzistenca. Pluralizmi dhe demokracia na ndihmojnë që të kemi këtë instrument shumë të madh: të mos e mbyllim gojën, por ta hapim gojën të gjithë së bashku në parlament. Por institucionet e pavarura, që kanë edhe qetësinë, kanë edhe distancën e duhur për ta bërë këtë gjë, duhet ta bëjnë sot, sepse sot është koha e duhur, pasi kambanat po gjëmojnë në të gjitha drejtimet dhe janë të qarta.

Të qëndruarit dhe të përkundurit nëpër iluzione të marra, që vetëm i bëjnë shërbim pushtetit të ditës, shtimit të orëve për të shtyrë në pushtet apo marrëzive, që nuk kanë asnjë lidhje me realitetin, as atë ekonomik, as punësimin, që hidhen në këtë sallë, sigurisht, duhet të refuzohen. Ne mezi presim që argumente të forta, solide, të verifikuara dhe të certifikuara, të na vijnë nga Banka e Shqipërisë. Në këtë mënyrë alarmet ngrihen në kohën e duhur dhe tragjeditë parandalohen, por tragjedi më të rëndë sesa tragjedia ekonomike, nuk kemi se çfarë të kemi. Historia e shqiptarëve e ka provuar se ç'është thotë tragjedi ekonomike.

Situata është më e komplikuar se kurrë ndonjëherë; asgjë nuk është në vijë. Në vijë dhe të qetë janë vetëm arkat e qeverisë, që mbushen nga xhepat e qytetarëve, dhe arkat e oligarkëve që mbushen e fryhen si kurrë më parë. Të tërë të tjerëve u ka mbetur vetëm një zgjidhje: të ikin nga Shqipëria. Pikërisht për këtë situatë, më shumë se dramatike, një tragjedi të vërtetë ekonomikosociale, është koha për t'i thënë ndal. Ne presim që Banka e Shqipërisë të jetë gjithmonë në krahun e qytetarëve, të interesit më të mirë të tyre, të interesit më të lartë publik, sepse e keqja ndalet sot. Nesër është vonë dhe nuk do të kemi më nevojë për asnjë apel, për asnjë këshillë, se pastaj kaosi është ai që merr fjalën. Faleminderit!